



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:029083

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05579615

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr./..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit L.. R.. për shkak të veprës penale cenim i paprekshmërisë se banesave dhe objekteve nga neni 200 par 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.238/20 të datës 25.02.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të hapur për publiku, me datë 26.12.2023 dhe 15.04.2024 në prezencë të Prokurores se shtetit Ardiana Veseli, të pandehurit L.. R.. e ne mugës të të dëmtuarit Z.. D.., të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 16.04.2024 përpiloi këtë:

A K G J Y K I M

Ndaj të pandehurit,

L.. R.. i atësisë K.. i amësisë V.. e gjinisë Sh.. i lindur me, i lindur në Gj.– O.. me vendbanim në fsh. J.. e V.. K- Pejë, ku edhe jeton i divorcuar, baba i 1 fëmije, në bazë të letërnjoftimit me nr. i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 362 par.1 nën par 1.1 të KPP-së

REFUZOHET AKTAKUZA

Gjëja se:

Me datë 17.12.2018, rreth orës 17:00, në rr. "L.. D..", K. Pejë, pa autorizim dhe në mënyrë të kundërligjshme hynë në banesën e të dëmtuarit Z.. D.., në atë mënyrë që i pandehuri kishte arritur te siguroj çelësat kopje te banesës si dhe dokumentacionin kopje me qëllim të postimit në rrjetin social "merr jep" për shitje, ku si numër kontaktues e kishte vënë numrin telefonik .../...-..., me ç' rast me ta vërejtur i dëmtuari ka kontaktuar vëllain e tij-këtu dëshmitarin R.. D.. që ta shikoj pasi që i njëjti gjendej jashtë vendit, ku më të arrituri në banesë ka vërejtur se te njëjtës i ishte ndërruar cilindri i derës hyrse dhe nuk hapej me çelësin që e posedonte ky i fundit,

-me çka kishte për të kryer veprën penale cenim i paprekshmërisë se banesave dhe objekteve nga neni 200 par 1 të KPRK-së,

I dëmtuari Z.. D.. nga Peja rr. L.. D.. nr. ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civilë.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm me datën 25.02.2020, ka ngritë aktakuzën PP/II.nr.238/20 ndaj të pandehurit L.. R.. për shkak të veprës penale cenim i paprekshmërisë se banesave dhe objekteve nga neni 200 par 1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor të hapur për publikun , me datë 26.12.2023 dhe 15.04.2024 në prezencë të Prokurores se shtetit Ardiana Veseli, të pandehurit L.. R.. e ne mugës të të dëmtuarit Z.. D...

Pas shqyrtimit të provave ne fjalën përfundimtare Prokurorja e Shtetit është tërhequr nga akuza ndaj të pandehurit duke deklaruar se: gjate këtij shqyrtim i gjyqësor kam përfaqësuar aktakuzën PP.NR.238/20 te datës 25.05.2020, kundër te pandehurit L.. R.. për shkak të veprës penale cenimi pa prekshmërisë së banesave dhe objekteve nga nenin 200 par. të KPRK-së, ku pas administrimit të provave personale dhe materiale, ku gjatë këtij shqyrtimi gjyqësore kishim mundësin të dëgjojmë dëshmitarin R.. D.. i cili deklaroi se datën 17.12.20218 kishte vërejtur se dikush kishte arrit ta hap banesën e vëllai të tij të dëmtarit Z.. D.. ku dhe kishte arritur ta ndërronte cilindrin e derës së banesën, pasi kishte vërejtur se dikush ishte futur banës, një person i pa panjohur, meqë rast edhe e kishte njoftuar policinë, i nijeti deklaroi se dokumentet e banesës gjendeshin aty brenda dhe askush nuk i kishte marr dhe se nuk dyshohet ne askënd, e po ashtu gjatë këtij shqyrtimi gjyqësore kemi dëgjuar dëshmitarin R.Li cili ka deklaruar se fillimisht ne faqen merr jep e kemi par një bane ne shitje, ne numrin kontaktues kam kontaktuar me te njëjtën dhe jam takuar, i cili kishte një kapele ne kok, me te njëjtin e shikum banesën, me tha së është e prindi të tij, mi ka treguar letrat e banese, me tha se nenën e kam te sëmur ne gjermani, banesa ishte ne emër të Z.. D.. , e i cili dëshmitar ka deklaruar se pasi i morëm dokumentet kemi shkuar tek noteri për ta përkthyer, por noteri me njoftoi se duhet te jetë prezentë edhe pronari i banesës, dje me tha mos u ngut mos rreziko, të nijeti ja ktheva dokumentet dhe me nuk kemi pas kontakt, pas një kohe prap me ka thirr mi ka kërkuar disa te holla, ndërsa ky person mu ka prezantua ndoshta me emrin L.. por qe nga ana e policisë nuk kanë kërkuar që ta beje identifikimi e atij personi, dhe tani ne ketë seancë te shqyrtimit kryesor nuk jam ne gjendje ta identifikoj, pasi kur jemi takuar me te njëjtin ka qenë errësirë dhe gjithmonë e ka pas një kapele ne kok, kjo është e tera banesën nuk e kam blerë nga i njëjti.

Ndërsa nga provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor dhe atë raporti i polices E.. L.. i datës 17.12.2018, deklaratat e dëshmitarit R.. D.. e dhënë në stacionin policor në Pejë me datë 17.12.2018, deklaratat e dëshmitarit R.. L.. e dhënë në stacionin policor në Pejë me datë 17.12.2018, deklaratat e të dëmtuarit Z.. D.. e dhënë në stacionin policor në Pejë me datë 21.12.2018, si dhe foto dokumentacioni prej 1/3 fotove, raporti informues i datës 19.11.2019 raporti nga "I.." me nr. 431-2 i datës 11.03.2019, deklaratat e të pandehurit L.. R.. e dhënë në stacionin policor në Pejë me datë 27.12.2019, nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale për të cilin është akuzuar, shtuar faktin se i pandehuri edhe në polici e ka mohuar kryerjen e veprës penale, ndërsa sa si përket numrit kontaktues i cili ishte len në faqen merr jep e qe gjate këtij shqyrtimi gjyqësor u konstatua se ky numër ishte i regjistruar numër të ish bashkëshortes se të pendëhirit, ku pandehuri deklaroi se në kohën e kryerjes se kësaj veprë penale për të cilën akuzohet në i kishim shkuar bashkësinë martesore dhe asnjëherë se kam pas në posedim këtë numër telefoni, andaj nga të lart cekurat nuk kemi prova materiale apo personale qe do të vërtetonin se këtu i pandehuri L.. R.. të këtë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, e duke u thirrur ende në parimin in dubio pro reo tërhiqemi nga aktakuza ndaj të njëjtit.

Gjykata në kuptim të nenit 362 par.1 nën par 1.1 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqenëse prokurorja e shtetit hoqi dorë nga aktakuza PP/II.nr.238/23 e dt. 25.02.2020 ndaj të pandehurit L.. R..

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 362 par 1 nën par 1.1 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2020:029083, 16.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Edona Berisha Kastrati

Gjyqtari i vetëm gjygues

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.